



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201602408/8

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda :** *Rekomandim për vijimin e procedurave dhe kryerjen e procesit të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjes bujqësore NB Lukovë në emër të shtetasit P.Ç.*

**Drejtuar :** **Kryetarit të Bashksë Himarë**  
**Z. Jorgo Goro**

**VLORE**

*I nderuar z. Kryetar,*

Siç ju kemi bërë me dije, Institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë për shqyrtim ankesën e shtetasit P.Ç, me banim në Sarandë, në të cilën ngrihet shqetësimi ndaj Bashkisë Himarë, për mosvijimin e procedurave dhe kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore në fshatin Piqeras, ish-Ndërmarrja Bujqësore Lukovë, në bazë të VKM nr.337, datë 22.04.2015 "*Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve*".

Me marrjen në shqyrtim të ankesës, fillimisht jemi drejtuar me shkresë K3/P44-3 prot., datë 30.12.2016 Bashkisë Himarë, për marrjen e informacionit dhe shpjegimeve lidhur me shkaqet ligjore që justifikojnë organin që ju përfaqësoni, për zvarritjen prej 7 muajsh të procedurave për kalimin e tokës bujqësore në emër të subjektit P.Ç nga përdorimi në pronësi të tij, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në përgjigjen e dhënë nga Bashkia Himarë, me shkresë nr.35/1 prot., datë 20.01.2017 drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, sqarohet se, pasi verifikuat praktikën që lidhet me objektin e kërkesës të qytetarit P.Ç, organi juaj ka konstatuar pengesa ligjore për të cilat ju keni vënë në dijeni subjektin me konkluzionin se, vetëm pas plotësimit të tyre subjekti mund të përfitojnë tokë bujqësore sipas dispozitave ligjore në fuqi. Ndër dokumentet ligjore ju keni përmendur:

*"1...bashkëthemelues i kooperativës bujqësore Piqeras dhe më pas të NB Lukovë, ka qënë babai juaj F.Ç. Lidhur me këtë fakt, ju duhet të paraqiteni me **prokurë ose në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të babait tuaj.***

*2...bazuar në kërkesat e nenit 24, të Ligjit Nr.7501/1991 "Për Tokën", i ndryshuar, dhe pikat 1 dhe 2 të VKM Nr.255, datë 02.08.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", duhet të paraqitni **gjëndjen reale familjare të F.Ç më datë 01.08.1991** sipas akteve të gjëndjes civile.*

3...bazuar në kërkesat e nenit 316 e vijues dhe 348 të K.Civil, duhet të paraqitni detyrimisht prokurën e tyre ose **dëshminë e trashëgimisë ligjore**, ku të përcaktohet rrethi i trashëgimtarëve ligjorë të bashkëthemeluesit të ish-kooperativës bujqësore....”

Më tej, Institucioni i Avokatit të Popullit në vijim të procedurave për shqyrtimin e ankesës, ka vënë menjëherë në dijeni ankuesin mbi çështjet e ngritura në shkresën e tuaj, për të cilat ankuesi me anë të një shkrese ka dhënë shpjegime plotësuese, shoqëruar me bazën ligjore dhe me dokumentacionin shtesë, që vërtetojnë shkeljet ligjore të Bashkisë Himarë në procesin e miratimit të kërkesës dhe AMTP-së, sipas Formularit nr.6 plotësuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës të fshatit Piqeras në emër të subjektit P.Ç.

Pas marrjes së informacioneve, si dhe nga analiza konkrete e bazës ligjore që rregullon procesin e kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve, shpjegimet e dhëna nga organi që ju përfaqësoni dhe ballafaqimi me argumentet dhe dokumentet shoqëruese të subjektit ankues, evidentojmë se:

- Në Nenin 24, të Ligjit Nr.7501/1991 “Për tokën”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: *“Kriteret për ndarjen, regjistrimin, ndryshimin, kalimin në pronësi, vlerësimin e dhënien me qira të tokës, si dhe detyrat e kadastrës, caktohen nga Këshilli i Ministrave”.*
- Në zbatim të këtij detyrimi ligjor Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr.452, datë 17.10.1992 *“Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore”*, në të cilën **përcaktohen kategoritë e subjekteve që përfitojnë nga ndarja e tokës bujqësore pas ristrukturimit të NB-ve**, llojet e tokave, kufiri maksimal i sasisë së tokës për frymë që jepet në pronësi ose në përdorim, si dhe **kriteret që duhet të plotësojë çdo subjekt** për të qënë përfitues nga fondi tokës të NB-ve në bazë të VKM-së nr.255, date 2.8.1991.
- Në vijim, Këshilli i Ministrave ka bërë ndryshime të aktit nënligjor, si miratimi i VKM nr.161, datë 8.4.1993, *“Për disa shtesa e ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore”*, ku përcaktohet se, përfitues të tokave bujqësore që dalin tepër nga ristrukturimi i këtyre ndërmarrjeve, **përfshin edhe anëtarë të trungut të familjes që kanë dorëzuar tokë bujqësore për formimin e ish-kooperativës a të ndërmarrjes bujqësore**. Konkretisht, në paragrafin 2, të pikes 2 të VKM nr.161, datë 8.4.1993 thuhet shprehimisht se:  
*“Në ndërmarrjet bujqësore, të krijuara nga ish-kooperativat bujqësore me toka bujqësore të qytetarëve të një qyteti të caktuar, si dhe në ndërmarrjet bujqësore, të krijuara drejtpërdrejtë me toka bujqësore të qytetarëve po të një qyteti të caktuar, toka u jepet në përdorim punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore dhe anëtarëve të trungut të familjes që kanë dorëzuar tokë bujqësore për formimin e ish-kooperativës a të ndërmarrjes bujqësore dhe që banojnë në të njëjtin qytet, por jo më shumë se sipërfaqja e tokës që kanë dorëzuar.*  
*Në ndërmarrjet bujqësore të mësipërme, të cilat kanë edhe rrënjë ullaresh, toka dhe rrënjët e ullinjve u jepen në përdorim punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore, anëtarëve të familjes që kanë dorëzuar tokë dhe rrënjë ullaresh për formimin e ish-kooperativave a të ndërmarrjeve bujqësore, por jo më shumë tokë dhe rrënjë ullaresh sesa kanë dorëzuar”.*

Në këto kushte, z.F.Ç (babai ankuesit) siç **vërtetohet nga dokumentat arkivor dhe gjëndja civile e trungut** të kësaj familje të vitit në momentin e dorëzimit të tokës bujqësore, **rezulton të jetë bashkëthemelues i ish-kooperativës bujqësore Piqeras dhe më vonë ish-NB Lukovë.**

Nisur nga kjo situatë, me fillimin e zbatimit të VKM nr.161, datë 8.4.1993, si dhe Udhëzimit nr.5 të Këshillit të Ministrave, z.P.Ç, në cilësinë e trashëgimtarit të vetëm ligjor të trashëgimlënësit F.Ç, **vërtetuar me Dëshmi Trashëgimie Nr.13/1994**, ka dorëzuar dokumentet e nevojshme pranë Komisionit të Ndarjes së Tokës të fshatit Piqeras. Komisioni i Ndarjes së Tokës të fshatit Piqeras, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga shtetasi P.Ç dhe familjet e tjera bujqësore, si subjekte të Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndyshuar dhe akteve nënligjore në fuqi, ka plotësuar Formularin nr.6 me listën emërore të subjekteve që plotësonin kriteret për marrjen e tokës në përdorim. Në përbërje të listës të Formularit nr.6 ndodhet edhe subjekti P.Ç si përfitues i tokës bujqësore të NB Lukovë, për shkak se babai i tij F.Ç ka qënë bashkëthemelues i kësaj ndërmarrje bujqësore. Gjithashtu, nga viti 1993 dhe në vazhdim kjo pasuri disponohet lirisht dhe pa asnjë problem nga shtetasi P.Ç.

Referuar dinamikës që kanë pësuar ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim, si dhe dokumenteve shkresore evidentojmë faktin se, subjekti P.Ç vazhdimisht është drejtuar me kërkesa organit përgjegjës ish-Komuna Lukovë që përgjigjej për mbledhjen e dokumentacionit dhe zhvillimin e procedurës për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore familjeve bujqësore ose individëve që e kanë atë në përdorim, por konstatohet se subjekti asnjëherë nuk është njohur me shkaqet ligjore të refuzimit dhe zvarritjes së pajustificuar të kërkesës për plotësimin e AMTP-së mbi bazën e Formularit nr.6 për marrjen e tokës në përdorim të fshatit Piqeras, si nga ish-Komuna Lukovë dhe tani nga Bashkia Himarë, në varësi të të cilës ndodhet Njësia Administrative Lukovë.

Konkretisht, në nenin 2, të Ligjit nr.8053/1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: *“Përfjashtohen nga dhënia në pronësi:*

- 1. Tokat bujqësore që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ndodhen brenda vijës kufizuese të qyteteve, fshatrave ose qendrave të banuara.*
- 2. Tokat bujqësore të përfshira në zonat me përparësi turizmin, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.88, date 1.3.1993 "Për miratimin e zonave që kanë përparësi turizmin".*

***Në pikën 1 dhe 2 nuk përfshihen familjet ose individët që i kanë fituar këto toka bujqësore si bashkëthemelues të ish-kooperativave bujqësore apo të ndërmarrjeve bujqësore”,***

Nisur nga ky përcaktim që bëhet për bashkëthemeluesit e ish-kooperativave bujqësore apo ndërmarrjeve bujqësore, duket qartë se familja e z.F.Ç si bashkëthemeluese e ish-kooperativës bujqësore Piqeras dhe më vonë NB Lukovë, plotëson kriteret dhe Komuna Lukovë duhet të vijonte me procedurat për kalimin e tokës pa shpërblim në pronësi të trashëgimtarit ligjorë të kësaj familje, gjë e cila nuk ka ndodhur dhe z.P.Ç nuk është njohur me shkaqe të arsyeshme të refuzimit të kërkesës.

Po ashtu, Ligji Nr.171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, si dhe VKM Nr. 337, datë 22.4.2015 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, kanë për qëllim pikërisht përfundimin e procedurave ligjore të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore përfituesve sipas Ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, të ndryshuar.

### **I nderuar z. Kryetar,**

Në nenin 4, pika 1 të Ligji Nr.171/2014 thuhet shprehimisht se: “1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore është organi përgjegjës për ndjekjen dhe përfundimin e procedurave për pajisjen e subjekteve me AMTP, sipas kërkesave, kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj”, duke legjitimuar organin që ju përfaqësoni si përgjegjës për zbatimin e procedurave për pajisjen e subjekteve me aktet e marrjes së tokës në pronësi.

Ndërkohë, në pikën 3, të VKM Nr. 337, datë 22.4.2015, përcaktohen dokumentet që subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë pranë njësisë të qeverisjes vendore, konkretisht thuhet shprehimisht se:

“3. Subjektet e përcaktuara si ***bashkëthemeluese të ish-ndërmarrjes bujqësore***, sipas vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar, të cilat nuk janë pajisur me AMTP, për tokën bujqësore që kanë në përdorim faktik, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ***të paraqesin në njësinë e qeverisjes vendore:***

- a) kërkesën për pajisjen me AMTP, për tokën që kanë marrë në përdorim nga komisionet e ndarjes së tokës;
- b) dokumentacionin kadastral, hipotekor, arkivor apo gjyqësor që provon pronësinë mbi tokën bujqësore apo rrënjët e ullinjve para reformës agrare dhe qenien e tyre si themelues të ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore;
- c) planvendosjen e ngastrës/ave që subjekti përdor për qëllime bujqësore, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët;
- ç) certifikatën e trungut familjar (përbërjen e familjes) në momentin e dorëzimit të tokës bujqësore dhe çdo dokument tjetër, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;
- d) aktin e marrjes së tokës bujqësore në përdorim, nëse e disponojnë”.

Bazuar në përcaktimet ligjore të sipërcituara, z. P.Ç është drejtuar me kërkesë dhe dokumentet shoqëruese sipas pikës 3, të VKM Nr. 337, datë 22.4.2015 organit Bashkia Himarë, për plotësimin e AMTP-së mbi bazën e Formularit nr.6, por prej 7(shtatë) muaj, kërkesa e subjektit nuk është miratuar dhe për më tepër, arsyet e përmendura në shkresën me përgjigje nr.343 prot., datë 31.11.2016 të Bashkisë Himarë drejtuar z. P.Ç, konstatojmë se nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim.

Për sa më sipër, në mbeshtetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 21/b, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku thuhet shprehimisht se:

*“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit.....,*

*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

*“Pas përfundimit të hetimit Avokati i Popullit kryen këto veprime:*

*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Bashkia Himarë të vijojë procedurat për kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të z. P. Ç, mbi bazën e Formularit nr.6 të Komisionit të Ndarjes së Tokës të fshatit Piqeras, Njësia Administrative Lukovë, sipas dispozitave të parashikuara në Ligjin Nr.171/2014 “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, si dhe VKM Nr. 337, datë 22.4.2015 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.

*Bashkëlidhur këti rekomandimi po ju dërgojmë:*

- Dëshmi Trashëgimie Nr.13/1994
- Çertifikatë familjare të vitit 1963 – 1974 e në vazhdim
- Çertifikatë vdekje të babait (F.Ç) në vitin 1975
- Shkresë e Ministrisë së Bujqësisë nr.346 prot., datë 1.02.2008

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

*Duke besuar në mirëkuptimin tuaj,*

**KOMISIONERE**

**Etilda GJONAJ (SALIU)**